

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Hashim Çollaku kryetar i kolegjit, Ferit Osmani dhe Shqipe Qerimi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Shaban Prekalla, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.Q., nga Prishtina, për shkak veprës penale Rrezikimi trafikut publik, nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 4 dhe 1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.4483/2018, datë 25.10.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 24.12.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.4483/2018, datë 25.10.2018, **vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktgjykimin P.nr.4483/2018, datë 25.10.2018, të akuzuarin A.Q., e ka shpall fajtor për shkak të veprës penale, Rrezikimi trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 4 dhe 1 të KPRK-së, dhe i është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në qoftë se i akuzuari gjatë kësaj kohe nuk kryen vepër të re penale. I akuzuari është obliguar që ti paguaj t gjitha shpenzimet procedurale dhe atë në emër të ekspertizës së komunikacionit shumën në lartësi prej 40.88 €, në emër të ekspertizës mjeko ligjore shumën prej 20 €, kurse në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 20 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Pala e dëmtuar, për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt juridiko-civil.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur Prokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, dhe atë vetëm për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë, aktgjykimin e ankimuar ta ndryshojë dhe të akuzuarit t'i shqiptoj dënim me të lartë me burgim.

Prokurori i Apelit, me parashtresën me shkrim PPA/II.nr.1254/2018, datë 07.12.2018 ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, e ushtruar kundër aktgjykimit i Gjykatës Themelore në Prishtinë, ashtu që të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar dhe ndaj të akuzuarit të shqiptohet dënim me i lartë me burgim.

Gjykata e Apelit, pasi shqyrtoj të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 të KPPK-së, dhe pas vlerësimeve të pretendimeve në ankesë, gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, më gjithat Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj edhe në këtë aspekt, konform dispozitës së nenit 394 të KPPK-së dhe konstatoj se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij, si dhe as shkelje të Ligjit Penal në dëm të akuzuarit.

Po ashtu as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi e kësaj gjykate, ngase në ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës, edhe gjykata është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj sipas nenit 383 par. 2 të KPPK-së, ndaj aktgjykimit që është marrë në bazë të pranimit të fajësisë ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen e fakteve, aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore sa i përket vendimit për dënim.

Sa i përket vendimit për dënim, Prokurori i shtetit në ankesë pretendon se, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike por vendimin mbi sanksionin penal është i butë se me rastin e shqiptimit të dënim me kusht gjykata e shkallës së parë nuk ka marrë parasysh dënueshmërin e veprës penale të kryer ku është paraparë dënimi prej 1 deri në 8 vite, e cila dispozitë bie në kundërshtim me nenin 50 të KPRK-së, se gjykata e shkallës së parë i ka marrë parasysh rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, mirëpo rrethanat lehtësuese i ka mbivlerësuar sikurse që është pranimi i fajësisë i të akuzuarit, ndërsa rrethana posaçërisht rënduese nuk ka gjetur për shkak se nuk i ka kushtuar kujdesin e duhur faktin se i akuzuari ka kryer veprë të rëndë me pasoja të rënda për të dëmtuarën e cila është e moshës relativisht të vjetër, e cila pas aksidentit është trajtuar edhe për një kohë shumë të gjatë, mosinteresimin e të akuzuarit pas aksidentit për të dëmtuarën dhe nga gjitha këto propozon që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i lartë me burg me të cilën do të arrihet qëllimi i dënimit.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, pretendimet e më sipërme ankimore të Prokurorit për ndryshimin e aktgjykimit të ankimuar në atë mënyrë që aktgjykimi të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i ashpër-dënim me burgim efektiv, nuk janë të bazuara. Gjykata e shkallës së parë konform dispozitës së nenit 73 të KPRK-së, i ka vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, me ç' rast për të akuzuarin si rrethanë lehtësuese gjeti se i akuzuari e ka pranuar fajësinë, është i gjendjes së varfër ekonomike, ka pasur sjellje të mirë gjatë seancës, ka premtuar se në të ardhmen nuk do të bije ndesh me ligjin, ndërsa posaçërisht rënduese nuk ka gjetur, dhe në prezencë të këtyre rrethanave të akuzuarit i shqiptoj dënim të kushtëzuar me të cilin do të arrihet qëllimi i dënimit në kuptim të nenit 41 të KPRK-ës. Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe vlerëson se dënimi i shqiptuar të akuzuarit nga ana e gjykatës së

shkallës së parë është i drejtë dhe në pajtim me dispozitat ligjore. Rrethanat e pretenduara rënduese në ankesën e Prokurorit, sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk janë të asaj rëndësie që të ndikonin në shqiptimin e një dënimi tjetër nga ai të cilin e ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë, pastaj duke marrë për bazë, posaçërisht pranimin e fajësisë së të akuzuarit për veprën e kryer, premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të kryej veprë tjetër penale, si dhe faktin se ka kaluar një kohë bukur e gjatë nga kryerja e kësaj vepre penale (mbi 5 vite) dhe se gjatë kësaj periudhe i akuzuari nuk ka kryer veprë tjetër penale e duke marrë parasysh edhe rrethanat tjera të konstatuara nga gjykata e shkallës së parë, e me qenë se në ankesë nuk ceket ndonjë rrethanë e re rënduese, e cila kishte me pas ndikim në shqiptimin e një dënimi më të ashpër, e posaçërisht duke marrë parasysh faktin e pranimit të fajësisë se të akuzuarit, andaj, nga te gjitha këto, kjo gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar është në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si ekzekutor dhe me intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, e posaçërisht duhet të jetë në funksion të preventives gjenerale dhe individuale, forcimit të moralit të shoqërisë si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me dënimin e shqiptuar kryerësi do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëhet rehabilitimi i tij dhe do të ndikoj në përmbajtjen e personave tjerë nga kryerja e veprës penale, kjo gjykatë konsideron se me dënimin e shqiptuar të akuzuarit nga gjykata e shkallës së parë do të arrihet edhe qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitat e neni 41 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PA1.nr.1251/18, datë 20.12.2018

Zyrtari ligjor
Shaban Prekalla

Kryetari i kolegjit
Hashim Çollaku

Anëtarët e kolegjit:

Ferit Osmani
Biljana Rexhiq